

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“BLERJE KARBURANT ,VAJ GRASO,GAZ,BENZIN”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP) :

09100000-0 KARBURANTE

VLERA E FONDIT LIMIT:

18 333 334 (tetëmbëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e kater) Lekë pa TVSH ose 190 734 (njëqinde e nentëdhjetë mijë e shtatëqinde e tridhjetë e kater) Euro pa TVSH. Kursi zyrtar i këmbimit i datës 11.03.2026 është 96.12 Lekë për njësi të monedhës së huaj.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, **Bashkia Finiq**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur/fondit limit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit që prokurohet, është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”*.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit me nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 43, pika 4 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në pikën 5 të nenit 61 të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes të operatorit

ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (*apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot*).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme ose leje tregëtimi në përputhje me dhe në zbatim të Ligjit nr.8450, date 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre .”i ndryshuar dhe VKM Nr. 970, date 2.12.2015“Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999” Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës,

të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar. Kriteret e vendosur në referencë të dispozitave të sipërcituar, përcaktojnë se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm, vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, dhe duhet të jetë i pajisur me licencat profesionale, të lëshuara nga autoritete kompetente shtetërore, që vërtetojnë pajtueshmërinë e ofertuesit me standardet e kërkuara në legjislacionin e sipërpërmendur. Pra konsiderohen si kritere të lidhura ngushtësisht me objektin e kontratës që prokurrohet dhe i bazuar në LPP.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë analizë për produktet e kërkuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) ose nga një organ/subjekt kompetent i certifikuar/autorizuar/akredituar, i cili duhet të jetë në përputhje me standartet në fuqi dhe ku të jenë qartësisht të përcaktuara të gjitha të dhënat e këtij artikulli, me qëllim krahasimin e tij me specifikimet teknike. Fletë analiza të jetë e lëshuar jo më herët se 30 ditë nga data e hapjes së ofertave.

Argumentim: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që mund të dorëzojnë dëshmi për rezultate dhe testime zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, me anë të së cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike brenda një afati të arsyeshëm.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI), që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standardeve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë përgjatë vitit të fundit nga data e zhvillimit të procedurës.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 40, pika 7, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar me anë të cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se e ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor duke mos patur penalitete përgjatë vitit 2024.

2.3.5 Subjekti ofertues duhet të ketë minimalisht 1 (një) stacion të tregëtimit me pakicë të karburantit brenda teritorit të Bashkisë Finiq, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale qeraje ose akt pronësie,ose të jenë të pasqyruara në ekstratin tregtar të operatorit ekonomik pjesmarrës.

Stacionet e tregëtimit me pakicë të karburanteve detyrimisht duhet të jenë të pajisur liçencë ose leje tregëtimi në përputhje me dhe në zbatim të Ligjit nr.8450, date 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre .”I ndryshuar dhe VKM

Nr. 970, date 2.12.2015“Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.”

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) dhe 7 c.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe

Në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve, VKM nr 344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin në VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve të saj” dhe Ligjit Nr. 10 448, datë 14.7.2011 “ Për lejet e mjedisit”.

Duke qenë se Bashkia Finiq ka një numër të konsiderueshem mjetesh, do të ishte e nevojshme që subjekti ofertues të ketë minimalisht 1 stacion të tregtimit me pakicë të karburantit. Para vendosjes së këtij kriteri NJHD ka bërë hetim të tregut dhe ka konstatuar se ka disa operatorë që kanë 1 (një) stacion të tregtimit me pakicë të karburantit brenda teritorit të Bashkise Finiq.

2.3.6 Subjekti ofertues duhet të paraqesë dhe deklaratat si më poshtë:

- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë në shërbim 24 orë, me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor, me tollon ose kartë elektronike , sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Subjekti duhet të deklarojë se mer përsiper furnizimin me karburant detyrimisht me pistolette publike.
- Subjekti duhet të deklaroje se mer përsiper që të konvertojë të gjithë sasinë e litrave të ndodhura në karten elektronike të personalizuar me targën e mjetit me tollon. Deri në përfundimin e plotë të kontratës sipas nevojave të autoritetit kontraktor.Karta elektronike duhet të jetë pa afat skadence deri në përfundimin e plotë të kontratës.
- Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar sipas adresave të Autoritetit Kontraktor.
- Bazuar në VKM nr.561 date 29. 07.2016 “ Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve në njësinë e qeverisjes së përgjithshme” Operatorët ekonomik pjesmerës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage),ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nepërmjet kartës elektronike.
- Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofroje shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori Ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor me qëllim që

rimbushja e kartave elektronike të personalizuara me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet autoriteti kontraktor.

- Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara me sipër në mënyrë elektronike nepërmjet faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage) që ofron çdo operator ekonomik pjesmarrës përben shkak për skualifikim.

Argumentimi: Në bazë, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që disponibilitet te nevojshme për realizimin me sukses të kontratës sipas kerkesave te AK.

Bazuar në VKM nr.561 date 29. 07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve në njësinë e qeverisjes së përgjithshme” Operoret ekonomik pjesmarës duhet te ofrojne nje faqe menaxhimi të karburanteve (webpage),ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike.

Shenim:

Për operatorin ekonomik të huaj në përmbushje të kriterëve të përcaktuara në pikën 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” dhe në pikën 2.3 ”Kapaciteti teknik”, nëse dokumentet e kërkuara nuk ekzistojnë sipas dispozitave të ligjit vendas të tij, atëherë, operatori ekonomik i huaj duhet të paraqesë dokumentet ekuivalente me to në përmbushje të secilin prej këtyre kriterëve.

Lidhur me paraqitjen e dokumenteve me Vulë Apostile:

1. Çdo ofertues i huaj është i detyruar të dorëzojë dokumentet e kërkuara në DT me vulë apostile, e cila dëshmon autenticitetin dhe ligjshmërinë e këtyre dokumenteve në nivel ndërkombëtar. Vulën apostile duhet ta sigurojnë për dokumentet origjinale të cituara si më poshtë:
 - Certifikatat e regjistrimit të biznesit
 - Vërtetimet e pagesës së taksave, tatimeve.
 - Dokumentet e autorizimeve ligjore, licencave, certifikatave të lëshuara nga ente shtetërore.
 - Çdo dokument tjetër që lëshohet nga institucione shtetërore që kërkohet në kuadër të kriterëve të kualifikimit.
2. **Vërtetimi i apostilës:**

Apostilizimi i dokumentave të paraqitura nga Operatori Ekonomik duhet te kryhet nga autoritetet përkatëse të shtetit të origjinës, në përputhje me Konventën e Hagës të vitit 1961. Dokumentet pa vulë apostile nuk do të pranohen.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike që janë hartuar për mallin objekt prokurimi, përshkruajnë elementët më të rëndësishëm përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” dhe Direktivës Evropiane të lëndëve djegëse 98/70/EC, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance dhe çdo standard të kërkuar**, referuar kërkesave dhe standardeve ndërkombëtare për automjetet.